



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 69, Datë 01.03.2021

PËR

**PEZULLIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË DORËHEQJES TË
MAGJISTRATIT PËR GJYQTARIN E GJYKATËS SË APELIT DURRËS,
Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, në nenin 65, në nenin 139 pika 2 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 36 pika 3 të Kodit të Procedurës Civile, në nenin 66, 67 të Kodit të Procedurës Administrative pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit të gjyqtarit {...}, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI

1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së dorëheqjes të magjistratit z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Durrës, deri në përfundim të hetimit dhe/ose procedimit disiplinor.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, në Gjykatën Administrative të Apelit, bashkë me vendimin përfundimtar.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR